

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** përmes gjyqtares Mevlide Shabani, në çështjen kontestimore të paditësit Sh. N. nga fshati V., Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shabi Isufi, avokat nga Gjilani, ndaj të paditurve T. S. nga fshati V., Komuna e Gjilanit të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Abdullah Ismajli, avokat nga Gjilani si dhe N. N. nga fshati V., Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti pengim posedimi, pas mbajtës së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datë 26.07.2018, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET SI E PABAZUAR** kërkesëpadia e paditësit Sh. N. nga fshati V., Komuna e Gjilanit, me të cilin ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit T. S. dhe N. N., që të dy nga fshati V...., Komuna e Gjilanit, kanë penguar paditësin në shfrytëzimin e fundit faktik dhe të qetë të pronës së tij, shtëpisë me oborr, në njësinë kadastrale P-7040300600340-3 dhe P-7040300600340-4, me kulturë tokë ndërtimore e cila gjendet në fshatin Velekincë, Komuna e Gjilanit, në sipërfaqe të tërësishme prej 979 m<sup>2</sup> dhe që të obligohen të paditurit, i padituri i parë ta vendosë ventilin kthyes në pusetën e kanalizimit para shtëpisë së paditësit në rrugë dhe i padituri i dytë ta vendosin rrethojën me tel në gjendjen e mëparshme.

**II.** Propozimi për caktimin e masës së sigurimit konsiderohet i tërhequr.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

### **A r s y e t i m i**

Paditesi, Sh. N. nga fshati V....., Komuna e Gjilanit, përmes të autorizuarit të tij, me dt. 27.07.2017 pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi për pengim posedim me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, me të cilin ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit T. S. dhe N. N., që të dy nga fshati V....., Komuna e Gjilanit, kanë penguar paditësin në shfrytëzimin e fundit faktik dhe të qetë të pronës së tij, shtëpisë me oborr, në njësinë kadastrale P-7040300600340-3 dhe P-7040300600340-4, me kulturë tokë ndërtimore e cila gjendet në fshatin V..., Komuna e Gjilanit, në sipërfaqe të tërësishme prej 979 m<sup>2</sup> dhe që të obligohen të paditurit, i padituri i parë ta vendosë ventilin kthyes në pusetën e kanalizimit para shtëpisë së paditësit në rrugë dhe i padituri i dytë ta vendosin rrethojën me tel në gjendjen e mëparshme.

Gjykata me Aktvendimin C.nr.523/2017 të dt.27.07.2017 e ka aprovuar masën e përkohshme të sigurisë të propozuar nga ana e paditësit - propozuesit Sh. N. dhe e ka obliguar të paditurin e parë T. S. që ventilin kthyes ta vendos në pusetën e rrugës para shtëpisë së paditësit,

ndërsa i padituri i dytë ta vendos rrethojën me tela para shtëpisë së paditësit në pikat kufitare të ngastrës së paditësit siç ka qenë para pengimit të përcaktuar me ekspert gjeodet.

Ndaj aktvendimit të lartcekur të paditurit – kundërshtarët e sigurimit kanë ushtruar kundërshtim me të cilin në tërësi e kanë kundërshtuar aktvendimin në fjalë.

Në seancën e dt. 25.01.2018 lidhur me kundërshtimin mbi aktvendimin për masë të përkohshme të sigurisë gjykata ka aprovuar propozimin e të autorit të paditësit si dhe të autorizuarit të të paditurit të parë dhe vet të paditurit të dytë që seanca të shndërrohet në shqyrtim përgatitor.

### **Pretendimet e palëve gjyqësore**

Paditësi, përkatësisht i autorizuari i tij, në seancën përgatitore, kryesore si dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se nga provat e prezantuara dhe ekspertiza e ekspertit gjeodet dhe ekspertiza shtesë vërtetohet në mënyrë të pakontestueshme se të paditurit e kanë penguar paditësin ashtu që i padituri i parë i ka pamundësuar shfrytëzimin normal të kanalizimit të ujërave të zeza duke ia hequr ventilin kthyes të cilin paditësi e kishte vendosur që në momentin kur puseta e kanalizimit të mbushet, ky ventil të mbyllet dhe kështu ujërat e zeza të mos i shkojnë në shtëpi, fakt ky që vërtetohet me daljen e gjykatës në vend të ngjarjes. Sa i përket pengim posedimit nga i padituri tjetër me ekspertizën shtesë vërtetohet se i padituri i dytë ka mënjeluar me vetë pushtet rrethojën në parcelën 340-4, pronë e paditësit dhe këtë fakt e ka vërtetuar eksperti gjeodet. Andaj sa i përket pengim posedimit për të paditurin e dytë është fakt notor se kemi të bëjmë me pengim posedim.

I autorizuari i të paditurit të parë ka deklaruar se sa i përket padisë për pengim posedim, të njëjtën e kundërshton në tërësi si të pabazuar, të padëshmuar dhe të paargumentuar, po ashtu i njëjti deklaron se sa i përket pusetës kontestuese, e njëjta është e vendosur në pronën e të paditurit T., në të cilën pa të drejtë dhe në mënyrë ilegale është kyçur paditësi në këtë pusetë të cilën e kishte ndërtuar i padituri. I njëjti deklaron se nga shfrytëzimi i kësaj pusete i padituri ka pësuar dëme, ashtu që nga ajo pusetë kanë hyrë fekale në shtëpinë e të paditurit, kështu që i padituri ca herë ia ka tërhequr vërejtjen paditësit se po i pengon në shfrytëzimin e pronës së tij duke i lëshuar ujërat, mirëpo i njëjti fare nuk ka dëgjuar dhe e ka injoruar kërkesën e të paditurit, ashtu që i padituri ka qenë i detyruar që ta mbyllë pusetën kontestuese.

I padituri T. S. ka deklaruar se pusetën kontestuese e shfrytëzon që nga viti 2005, por se gypi të cilin e ka shfrytëzuar nuk ka pasur kapacitet as për shtëpinë e të njëjtit, ndërsa vëllai i tij ka kërkuar që të lidhet në atë pusetë përkohësisht, e siç deklaron i padituri në kohën kur është kyçur vëllai i tij – paditësi, i padituri nuk ka qenë në shtëpi, dhe me të kuptuar për këtë i padituri deklaron se ka kërkuar nga paditësi që menjëherë ta largojë gypin në fjalë, por se i njëjti nuk e ka larguar.

I padituri i dytë N. N. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve të dhëna në këtë gjykatë duke theksuar përsëri se i njëjti nuk e ka penguar paditësin, por se paditësi i ka penguar ata, duke vendosur tel në rrugën në të cilën kalon i padituri dhe familja e tij e gjerë prej 10 shtëpive, e cila rrugë është e destinuar për kalim që nga viti 1973, ndërsa paditësi telin e ka vendosur në korrik të vitit 2017, ku pasi që i padituri e ka parë atë tel e ka larguar për ta hapur rrugën për të kaluar.

### **Provat e administruar**

Gjykata për ta vërtetuar gjendjen faktike dhe për të vepruar drejt në lidhje me këtë çështje, në shqyrtimin gjyqësor administroi dhe vlerësoi këto provat materiale: Certifikata pronësore me nr. të lëndës 7721/2017 e dt.21.07.2017 në emër të Sh. N.; Certifikata me nr. të lëndës 8651-2016 e dt.03.08.2016 në emër të T. S.; Leja për ndërhyrje në infrastrukturë e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime publike me nr.343-65718 e dt.03.07.2018, në emër të T. S. nga fshati V.....; Ekspertiza e dt.04.12.2017 së bashku me Konstatimin dhe Mendimin e ekspertit Bujar Kurteshi nga Gjilani; Ekspertiza shtesë e dt.16.02.2018 së bashku me konstatimin e dhënë po ashtu nga eksperti gjeodet Bujar Kurteshi; Opinioni - Vlerësimi i dt.03.05.2018 i dhënë nga eksperti gjyqësor i ndërtimtarisë Rexhep Sylejmani si dhe Procesverbali mbi inspektimin i lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim - Inspeksioni i Shërbimeve Publike i Komunës së Gjilanit me nr. 08.01.85 i dt. 07.07.2017 në emër të Tefik Sinani.

**Sh. N. i dëgjuar në cilësi të palës në mes tjerash ka deklaruar se** të paditurin T. e ka vëlla, ndërsa të paditurin tjetër N. e ka nip. Pusetën e kanalizimit tani kontestuese deklaron se e ka ndërtuar vëllai i tij – i padituri T. për nevojat e shtëpisë së tij, ndërsa pas ndërtimit të shtëpisë së tij në vitin 2004 i njëjti është kyqur në pusetën kontestuese deri në vitin 2017 kur i padituri T. i kishte thënë atij se nga të reshurat atmosferike uji nga kanalizimii cili ishte mbledhur në pusetë iu kishte kthyer të paditurit T. në podrumin e tij të cilën e shfrytëzon si dhomë banimi dhe për këtë arsye të njëjtën e kishte mbyllur. Paditësi më tutje deklaron se nuk ka alternativë tjetër për tu kyqur me rrjetin e kanalizimit të fshatit pasi që për tu lidhur në këtë pusetë duhet të thehet betoni i hyrjes së garazhës gjë që kushton së paku 10.000 euro. Në pusetën e fshatit nga shtëpia e tij derdhen vetëm ujërat e tri banjove, ndërsa ujërat tjera të shtëpisë së tij dy kuzhinave dhe ujit të podrumit shkojnë përmes pusetës tjetër.

Kësaj deklarate gjykata nuk ia fali besimin për shkak se e njëjta ishte në kundërshtim me provat e administruara.

Eksperti i ndërtimtarisë Rexhep Sylejmani lidhur me konstatimin dhe mendimin e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë konstatimit-dorëzimit me shkrim të përshkrimit sipas skicës dhe e njofton gjykatën se ka alternativë tjetër për tu zgjidhë ky kontest, e të cilën i njëjti e ka paraqitur përmes skicës ku ekziston mundësia më e lehtë dhe më e lirë për tu ekzekutuar dhe për tu evituar problemet e deritanishme. Po ashtu i njëjti e njofton gjykatën

se gypi i cili vije nga shtëpia e paditësit për te puseta e cila është kontestuese mund të ndërpritet para se të vije te puseta kontestuese dhe të bëhet një kanal që lidhet një gyp i ri në pusetën e fshatit dhe me atë evitohen të gjitha problemet, pasi që shpenzimet për të vazhduar në gypin tjetër mund të sillen rreth 500 €.

Kësaj deklarate si dhe konstatimit të këtij eksperti të dhënë me shkrim gjykata ia fali besimin e plotë për arsye se eksperti në mënyrë të qartë ka sqaruar se ka mundësi dhe alternativë tjetër për zgjidhjen e këtij problemi.

### **Vlerësimet faktike të gjykatës**

Nga administrimi i provave të lartcekura dhe çmuarjes së tyre veç e veç dhe ato të gjitha së bashku gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se palët ndërgjyqëse janë familjar përkatësisht paditësi të paditurin e parë e ka vëlla ndërsa të paditurin e dytë e ka nip (djalë të vëllait). Meqenëse i padituri i parë T. për nevojat e shtëpisë së tij kishte hapur pusetën e kanalizimit e më pas paditësi po ashtu për nevojat e një pjese të shtëpisë së tij ishte kyçur po në këtë pusetë për derdhjen e ujërave të zeza, ndërsa për një pjesë tjetër të shtëpisë ishte kyçur në rrjet të kanalizimit të fshatit, e meqenëse në pusetën kontestuese ishte kyçur pa lejen e të paditurit ku më pas të njëjtit i janë shkaktuar dëme nga të reshurat atmosferike, i padituri e kishte pasivizuar rrjedhën e gypit të paditësit, meqenëse paditësi kishte alternativë tjetër për kyçje në kanalizim e që këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklarata e të paditurit T. si dhe nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit vlerësues të paluajtshmërie Rexhep Sylejmani.

Gjithashtu sa i përket pretendimeve të paditësit për pengim posedimi lidhur me largimin e rrethojës së telit gjykata me rastin e daljes në vendin e ngjarjes ka vërtetuar faktin se teli rrethues ishte vendosur nga paditësi në skajin e rrugës e cila kishte qenë e lirë për kalimin e jo vetëm të paditurit të dytë por edhe të personave tjerë të cilët kalonin në këtë rrugë për në shtëpitë e tyre, mirëpo këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklarata e të paditurit N. N. i cili ka deklaruar se ngastra kontestuese në të cilën paditësi e ka vendosur rrethojën e telit, ajo ngastër ka shërbyer si rrugë të cilën e ka shfrytëzuar i padituri Nexhat me familjen e tij të gjerë për një kohë të gjatë dhe gjatë asaj kohe nuk kishte pasur pengesa nga paditësi.

### **Dispozitat e aplikueshme**

Gjykata pasi që administroi dhe vlerësoi provat e paraqitura nga ndërgjyqësit, ku nga këto prova paditësi nuk arriti që ta vërteton faktin se i njëjti e ka pasur në posedim të ligjshëm pusetën kontestuese për të cilën pretendon, meqë nga administrimi i provave u vërtetua se paditësi është kyçur në pusetën kontestuese pa dëshirën dhe vullnetin e të paditurit, gjë që është në kundërshtim me nenin 104 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, ku si kusht për fitimin e posedimit parashihet marrëveshja në mes të

poseduesit të mëparshëm dhe fituesit të posedimit, e që në rastin konkret nuk ka pasur marrëveshje në mes të paditësit dhe të paditurit për kyçje në pusetë.

Sa i përket kërkesës së paditësit lidhur me pengimin për ngastrën kontestuese lidhur me vendosjen e rrethojës, gjykata vlerëson se kjo kërkesë e paditësit nuk është e vlefshme pasi që i padituri N. N. ka qenë duke e shfrytëzuar në mënyrë të qetë dhe të papenguar deri në momentin kur paditësi e ka vendosur rrethojën prej telit, duke e penguar kështu të paditurin në posedimin e qetë të kalimit për në shtëpinë e tij.

Gjykata e ka konsideruar të tërhequr propozimin për masën e sigurisë, meqenëse në shqyrtimin gjyqësor lidhur me shqyrtimin e kundërshtimit për masën e përkohshme, i autorizuari i paditësit i ka propozuar gjykatës që të kalohet në shqyrtim gjyqësor lidhur me çështjen kryesore me qëllim të ekonomizimit të procedurës, me të cilin propozim janë pajtuar edhe të paditurit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi konform nenit 450, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës.

Gjykata administroi edhe prova të tjera materiale por të njëjtat nuk u arsyetuan veç e veç pasi që nuk do të ndikonin në vendimin përfundimtar në këtë çështje civile kontestimore.

Andaj, nga të cekurat më lart dhe në kuptim të nenit 142 pika 1.dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjyqtarja**  
Mevlide Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 dite, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.